



## P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më datë: **20.09.2023**, me fillim në orën **10:15**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete, **z. Bajram Morina**. **Kryesuesi** – Fillimisht, përshëndetje për të gjithë, faleminderit për praninë tuaj! Përshëndetje për shefin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, z. Lendrit Qeli, përfaqësuesit të KFOR-it, OSBE-së, UNMIK-ut, zëvendëskryesuesin, drejtorin e DBPZhR-së, z. Berat Duraku, përshëndetje për anëtarët dhe të gjithë të pranishmit. Ky është takimi **i pestë** për vitin 2023, për takimin e sotëm, i kemi këto pika të rendit të ditës:

### R E N D I T E

1. **Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike, rreth projekteve të dedikuara për Komunitetin joshumicë;**
3. **Informatë nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, rreth mbështetjes me subvencione për fermerë, bujqit nga komuniteti joshumicë;**
4. **Informatë nga DKA-ja për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024;**
5. **Të ndryshme.**

**Kryesuesi** - Atëherë, e hedhim në votim rendin e ditës. Me shumicë të votave të anëtarëve, aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në piken e parë të rendit të ditës:

#### **1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

A ka dikush ndonjë vërejtje apo sugjerim për procesverbalin nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë unanime aprovohet procesverbalit.

#### **2. Informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike, rreth projekteve të dedikuara për Komunitetin joshumicë.**

**Lendrit Qeli** – Unë vetëm desha të jap një informatë te kjo pikë, pasi sapo me lajmëroi drejtori që qenka në takim në Ambasadën japoneze rreth një takimi me urgjencë sa i përket deponive ilegale, ndërsa sa i përket investimeve kapitale, ju e dini se ne kemi një bashkëpunim të ngushtë me drejtorinë dhe për informacione më të hollësishme keni të drejtë të kërkonit në takimet e ardhshme dhe kjo ishte vetëm si informacion për drejtorin dhe për ta justifikuar mosprezencën e tij.

**Ramë Berisha** – Përshëndetje për të gjithë! Kërkesa ime ka të bëjë për një lagje në Xërxë, në rrugën “Elena Gjika”, ku nuk ka trotuare gjatë kësaj rruge që disa vite, me një gjatësi prej 800 metra nga tuneli, deri te Shkolla Filllore “Hamez Thaqi”, pasi mungon trotuari për nxënësit e shkollës që e frekuentojnë atë rrugë dhe kjo sigurisht shkakton rrezik, si për nxënësit dhe të gjithë qytetarët që banojnë në atë pjesë.

**Faton Ramadani** – Përshëndetje kryesues, e falënderojmë drejtorin e Bujqësisë për prezencën e tij, përshëndetje për anëtarët e komitetit dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Mendoj që drejtori i Shërbimeve Publike është e treta here radhazi që nuk i përgjigjet ftesës së Komitetit për Komunitete dhe sigurisht se kjo është papërgjegjësi e

drejtorit karshi komitetit për Komunitete, pasi ka obligim të jetë prezent dhe kësisoj propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër të radhës, pasi kemi shumë për të diskutuar.

**Kryesuesi** – Pasi jemi në këtë pikë, drejtori i Shërbimeve Publike ka deleguar shefin e Kabinetit, z. Ali Morina, me informatat rreth kësaj pike.

**Ali Morina** – Faleminderit, i nderuar kryesues i Komitetit, të nderuar anëtarë të komitetit dhe të gjithë ju të pranishëm. Unë do të mundohem të flas për disa projekte për shkak të mosprezencës së drejtorit të Shërbimeve Publike edhe pse sot arsyetohet mungesa e tij për shkak të takimit që kishte në Ambasadën japoneze, por gjithsesi duhet të delegohet dikush nga drejtoria e Shërbimeve Publike për te dhënë sqarime të nevojshme. Edhe pse nuk kam shume informata sa i përket projekteve të drejtorisë së Shërbimeve Publike, por mund të flas për një projekt që kemi përfituar si grand, bashkë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku ka financuar me 50,000 euro, ndërsa ne me mbi 70,000 euro. Ky projekt ka të bëjë me ndërtimin e parqeve në Opterushë, Retijë, Dejnë dhe kolektori i ujërave të zeza në Ratkoc dhe Rahovec, që u dedikohen lagjeve të komuniteteve. Po ashtu, rreth problemeve të kanalizimit që i kanë pasur komunitetet joshumicë në fshatin Dobidol, tashme janë zgjidhur. Po ashtu, Drejtoria e Shërbimeve Publike është duke vazhduar me projektin e ndriçimit publik dhe nga ky projekt përfitojnë të gjitha komunitetet joshumicë dhe në ato lokalitete po përfshihet në masën 100% e projektit. Me kanalizim kemi kontratë me kompaninë dhe sigurisht se do të intervenojmë në të gjitha lokalitetet ku ka kërkesa dhe problematika rreth kanalizimit e po ashtu edhe me rrugët do të intervenojmë në të gjitha lokalitetet ku ka komunitete joshumicë, kështu që, për rrugë konkrete specifike, nuk i kam informatat e hollësishme, por gjithsesi nuk e amnistoj drejtorin që në mbledhjen e ardhshme të japë informata të detajuara.

**Kryesuesi** – E falënderoj shefin e Kabinetit për informatat e ofruara, por kisha kërkuar edhe nga anëtarët e tjerë që kjo pikë të vendoset edhe në takimin e radhës e që po besojmë që do të jetë prezent edhe drejtori i Shërbimeve Publike, z. Përparim Krasniqi.

### **3. Informatë nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, rreth mbështetjes me subvencione për fermerë, bujqit nga komuniteti joshumicë:**

**Berat Duraku** – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Fillimisht, ju kërkoj falje për mospjesëmarrje në seancën e kaluar për shkak të angazhimeve që i kemi pasur gjatë fatkeqësive natyrore. Sa i përket programit për zhvillimin e bujqësisë, më lejoni t'u njoftoj se ne e kemi të ndërlidhur me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të programit të ministrisë, ku ne jemi pjesë e këtij programi me të cilin fermerët e komunës tonë aplikojnë për subvencione, apo për pagesa të tjera direkte. Në këtë program, nuk janë të specifikuara, apo nuk ka kritere të cilat e bëjnë ndarjen në mes të komunitetit joshumicë dhe shumicë dhe të gjithë fermerët që aplikojnë në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të zyrarët tanë. Po ashtu, ministria e ka edhe pjesën e granteve, ku ne si Komunë kemi asistuar që t'u përgatisim dokumentacionin të gjithë fermerëve të komunës, që të kenë mundësi të aplikojnë dhe të përfitojnë grante nga Ministria e Bujqësisë. Ne vitin 2022, kemi asistuar te 4 fermerë të komunitetit joshumicë dhe prej tyre njëri është përfitues në kuadër të ministrisë. Sa u përket projekteve të Komunës tonë, në përkrahjen me subvencione dhe grante, po ashtu edhe në kuadër të programit për përkrahjen me mekanizëm bujqësor, kemi përfitues të komunitetit joshumicë, ku gjatë vitit 2022 dhe 2023, janë përfitues fermerë të komunitetit joshumicë, kryesisht të fshatit Hoçë e Madhe dhe prej tyre kanë përfituar 6 motokultivatorë, dy plugje dy-krahësh dhe një frezë 1.6 dhe të gjithë janë të publikuar në ueb-faqen e Komunës. Po ashtu, në fshatin Hoçë e Madhe, janë të regjistruar 96 fermerë, ku prej tyre, aktiv janë 72, të cilët aplikojnë në çdo formë në përfitimin nga institucionet tona, qoftë në nivelin qendror apo lokal. Pra, këto janë informatat në pika të shkurtra, pasi nuk kemi ndonjë kriter specifik për komunitetin joshumicë, pra të gjitha kriteret përcaktohen për të gjithë fermerët, që janë 3119 në komunën tonë dhe sigurisht se ata që i plotësojnë kriteret janë edhe përfitues nga institucioni i Komunës së Rahovecit.

**Faton Ramadani** – Faleminderit drejtor për informatën, siç e potencove për subvencionet që kanë përfituar kryesisht komuniteti serb, nga fshati Hoçë e Madhe, por unë po kërkoj nga ju që të ulni kriterin e përfituesve kryesisht të komunitetit joshumicë, nëse është e mundur, për shkak se ata nuk janë të barabartë me komunitetin tjetër dhe nuk mund të jenë përfitues, në raport me të tjerët, p.sh. një qytetar nga fshati Celinë, nga komuniteti egjiptian, është munduar me çdo kusht që të përfitojë një mjet bujqësor, por nuk po mundet të jetë përfitues për shkak të kriterit të paarrtshëm, apo kriteri ka qenë i barabartë për të gjitha komunitetet.

**Berat Duraku** – Me te drejtë është kërkesa juaj, pasi ne veçse kemi marrë masa për zbutjen e kritereve për komunitetin joshumicë dhe gjithashtu edhe për qytetarin e Celinës nga komuniteti egjiptian, në afatin e parë nuk kemi mundur ta ulim kriterin, por kemi kërkuar prej tij që të bëjë ankesë. Mirëpo, fatkeqësisht, nuk e ka bërë ankesën, por ne tani e kemi përzgjedhur si përfitues i motokultivatorit. Po ashtu, ju njoftoj se nga komunitetet e tjera joshumicë, ka përfitues, mirëpo tani nuk i kam të evidentuar, për shkak se nuk i kemi pasur kriteret e përcaktuara për komunitete, si p.sh. në Krushë të Madhe ka përfituar një fermer që merret me bujqësi, një motokultivator, por ka edhe në disa vendbanime të tjera dhe sigurisht që në të ardhmen do të parashohim edhe uljen e kriterit për përfitim nga komuniteti joshumicë.

#### **4. Informatë nga DKA-ja për përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollor 2023/2024:**

**Jeton Krasniqi** – Përshëndetje për ju kryesues i Komitetit për Komunitete, anëtar të komitetit dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Në mungesë të drejtorit do ta prezantoj informatën e cila ka të bëjë me përgatitjen e fillimit të vitit të ri shkollor. Pra, viti i ri shkollor 2023/2024 ka filluar më 1 shtator, përkundër viteve të tjera, për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia dhe të grevave të sindikalistëve. Viti i ri shkollor filloi në të gjitha shkollat e komunës tonë, me përjashtim të dy shkollave, ishin në renovim e sipër dhe të punimeve në ndërmarrjen e masave të eficiencës. Janë bërë përgatitjet nevojshme dhe të duhura sa i përket planifikimit të orëve dhe kuadrit mësimor, pastaj trajtimi i mësimdhënësve të rinj në disa fusha kurrikulare të programit fillor dhe parafillor. Mirëpo, në këtë vit, kishim një problem të papritur sa i përket furnizimit me tekste shkollore, pasi tekstet kësaj here duhet të blihen nga vetë prindërit, më pas të rimbursohen nga qeveria përmes platformës E-Kosova. Po ashtu, u mbajt provimi i dytë i maturës, ku morën pjesë 184 maturantë, të cilët nuk kishin arritur pragun e kalueshmërisë në afatin e parë. Këto ishin disa informatat që karakterizuan rreth përgatitjes së fillimit të vitit të ri shkollor 2023/2024, për më shumë, e keni informatën para vetes. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

**Faton Ramadani** – Faleminderit për informatën rreth përgatitjes së fillimit të vitit të ri shkollor. Pra, është fakt se ndërrimi i formës së pajisjes së nxënësve me tekste shkollore ka shkaktuar probleme, jo vetëm në komunën tonë, por në të gjitha komunat e Kosovës. Kjo formë e subvencionimit nëpërmjet platformës E-Kosova, është shumë problematike, sidomos për komunitetin joshumicë, mendoj se shumica absolute e komunitetit joshumicë kanë pasur problem të qasen nëpërmjet kësaj platforme, që të aplikojnë për subvencionim të mjeteve. Unë si mësimdhënës në shkollën e fshatit Celinë, ka edhe aty një numër të nxënësve të komunitetit joshumicë dhe kur i pyesim se pse nuk vijnë me libra, pasi kushtet e vështira ekonomike dhe nuk mund të pajisen me libra dhe gjithashtu nuk kanë aplikuar për subvencionim, për shkak se prindërit e tyre nuk kanë ditur të aplikojnë. Kështu që kam një pyetje për zyrтарin e Drejtorisë së Arsimit, a keni marrë ndonjë masë në raport me këtë çështje për t'i dhënë zgjidhje kësaj problematike, që të formoni ndonjë komision, qoftë nëpër shkolla, që t'u ndihmojnë atyre prindërve të aplikojnë dhe të subvencionohen me tekste shkollore.

**Jeton Krasniqi** – Në të gjitha shkollat e Komunës tonë, së bashku me drejtorët e shkollave, jemi dakorduar që si për komunitetin joshumicë, edhe për komunitetin shumicë, për të gjithë ata që nuk i kanë kushtet, për t'i evidentuar rastet edhe për t'i sjellë dhe më pas DKA-ja të marrë si prioritet rimbursimin që t'u ndihmojë fëmijëve që nuk kanë mundësi të pajisen me libra.

**Kryesuesi** – Pasi unë veproj në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Katër Dëshmorët”, në fshatin Ratkoc, si tutor, kemi asistuar në platformën E-Kosova, në aplikimin për nxënës rreth librave, që iu kemi ndihmuar nxënësve të komunitetit shumicë dhe joshumicë, kështu, sa i përket shkollës filllore në fshatin Ratkoc të komunitetit, nuk kemi probleme sa i përket aplikimit.

**Lendrit Qeli** – Sa për ta plotësuar kolegun nga Drejtoria e Arsimit, ZKKK-ja ka qenë e hapur në mbështetjen, apo asistimin e pjesëtarëve të komuniteteve në nevojë, që nuk kanë pasur mundësi të aplikojnë apo nuk kanë ditur deri te qasja, ku mbi 25 familje i kemi asistuar, por nga ky takim bëj apel që ende kemi mundësi t'u ndihmojmë deri në fund të muajit, në bazë të udhëzimit për të gjitha familjet që nuk kanë mundësi, munden lirisht të vijnë në zyrën tonë, pasi do t'i angazhojmë edhe dy vullnetare që do të kenë mundësi t'u ndihmojnë në procesin e aplikimit.

**Doruntine Sopjani** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! Kërkesa ime ka të bëjë me lagjen e komunitetit në fshatin Dobidol, lagjja e tyre gjendet përkaj hekurudhës dhe lidhet me rrugën “Mark Sopjani”, që janë gjithsej 5 shtëpi me gjithsej 40 banorë. Pra, qasja e tyre për në rrugë është jo e mirë, pasi skaj shtëpive të tyre gjendet kanali i ujërave atmosferike dhe kanë vendosur disa ura të improvizuara për të kaluar kanalin dhe për t'u lidhur me rrugën që është skaj hekurudhës, edhe pse ajo rrugë përket vetëm për këtë lagje. Kjo lagje vazhdimisht vërshohet kur kemi të reshura atmosferike, për shkak të kanalit të ujit, që është i ngarkuar çdoherë. Pra, kërkesa

ime është që këtyre 5 familjeve t'u rregullohet rruga me një gjatësi prej 150 metra dhe t'u ndërtohet një urë që lidhet me rrugën "Mark Sopjani".

**Lendrit Qeli** – Ne vetëm kemi intervenuar në një rast të tillë në fshatin Dobidol, në projektin e fundit në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe në kanalizim, nëse po flasim për të njëjtin vend, por si duket, bëhet fjalë për një vend tjetër që ballafaqohet me probleme të tilla.

**Ramë Berisha** – Nga koha e luftës e kam të plasaritur shtëpinë dhe kërkoj nga ZKKK-ja, konkretisht komuna, të më mundësohet në përmirësimin e gjendjes së shtëpisë, që të mos kemi ndonjë fatkeqësi njerëzore për shkak të dëmtimit.

**Lendrit Qeli** - Pasi jemi në pikën: Të ndryshme, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, në Asamblenë e kaluar, ka arritur që të kalojë Planin e veprimit për komunitetet romë dhe ashkali, një plan që do të ketë një efektshmëri të mundësisë për implementim, në krahasim me komunat e tjera dhe po besoj që jemi të parët që kemi arritur ta përfundojmë, kështu që kisha kërkuar edhe mbështetjen e Komitetit, që, në mënyrën më të mirë të mundshme të implementojmë këtë dokument si një politikë komunale dhe duke pasur parasysh ZKKK-ja mundësitë buxhetore që i ka në krahasim me drejtoritë e tjera, po planifikojmë, me mundësi, një konferencë të donatorëve që të iniciojmë mundësinë e bashkëpunimit që njëzëri të jemi më aktivë te pjesa e implementimit të dokumenteve dhe politikave që po hartohen në nivel lokal dhe qendror. Dhe ndërkohë dua t'i përgjigjem edhe bacës Ramë, pasi e di që gjendja në shtëpinë nuk është në nivelin e duhur dhe rrezikohet për shkak të dëmtimit që ka pësuar. Fatkeqësisht, këtë vit nuk kemi pasur mundësi të intervenojmë në rinovimin e shtëpive, për shkak se donatori nuk ka mjete të mjaftueshme për të funksionalizuar, duke përfshirë këtu edhe komunën tonë, por po shpresojmë që vitin e ardhshëm do të fillojmë prapë me rinovimin e shtëpive duke parë edhe kriteret që do të jenë e sigurisht se do të shohim mundësinë e mbështetjes së shtëpisë së bacës Ramë.

**Dusan Stojanovic** – Pyetje për z. Lendrit Qeli, se do të mbahet procesi i regjistrimit të popullsisë për këtë vit si dhe në komisionin e regjistrimit të popullsisë, a janë të përfshirë përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve, duke marrë parasysh edhe komunitetin serb nëpër komisione dhe ekupe që do të angazhohen në regjistrimin e popullsisë.

**Lendrit Qeli** – Sa i përket procesit të regjistrimit civil, që po besoj se e keni edhe informatën se qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar që të shtyhet për në vitin tjetër dhe me vendim jam i caktuar nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim që ta përfaqësojë komunitetin joshumicë në Komunën e Rahovecit dhe padyshim që do të ketë kontrollorë regjistruar dhe anëtarë të tjerë që do të merren me çështjen e regjistrimit, mirëpo tani për tani ende nuk e kemi të qartë pasi ende nuk është bërë publike se kur do të mbahet procesi i regjistrimit.

**Dusan Stojanovic** – Po ashtu, kam edhe një pyetje sa i përket çështjes së mëditjeve të cilat nuk po i marrim deri më tani dhe do të kërkoja që në mbledhjen e ardhshme të parashihet si pikë e rendit të ditës, prezenca e drejtorit të Financave që do të na sqarojë rreth problemit dhe çështjes së mëditjeve për mbledhjet që i mbajmë.


**Bajram Morina** – Pasi kemi anëtarë të komitetit që janë anëtarë edhe në Kuvend, kisha kërkuar nga anëtarët që të kërkojnë sqarim në mbledhje të Kuvendit rreth mëditjeve të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

**Faton Ramadani** – Pasi zëvendësi juaj kërkoi që të jetë prezent drejtori i Financave, gjithashtu edhe unë propozoj që mundet edhe një përfaqësues nga Financat që të na informojë se çka do të bisedohet.

**Kryesuesi** – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, konstatoj të mbyllur këtë takim dhe ju falënderoj për pjesëmarrjen.

**Mbledhja përfundoi në orën: 11:15**

**Procesmbajtësi:**

  
Agim Hoti



**Kryesuesi i mbledhjes:**

  
Bajram Morina